VENDIM
Nr.536, datë 22.8.2007

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT PËR DHËNIEN ME QIRA, ME ÇMIMIN SIMBOLIK NJË EURO, TË SIPËRFAQES 14 600 M^2, TË UZINËS SË VJETËR TË URESË, PËR NDËRTIMIN E NJË TERMOCENTRALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës publike, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira, me çmimin simbolik një euro, të sipërfaqes 14 600 m^2, ku përfshihen objektet, kulla e ftohjes, pompat e ujit, magazina e uzinës së vjetër të uresë, Fier, për ndërtimin e një termocentrali, të jenë sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Procedurat për dhënien me qira janë ato të përcaktuara në vendimin nr.162, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore".

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1

KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR DHËNIEN ME QIRA

	Përqindja e vlerësimit
a) Investimi	10
b) Punësimi	10
c) Kapaciteti i instaluar (në MW)	10
d) Disponibiliteti i impiantit (në përqindje)	10
e) Sasia vjetore e prodhimit (në MWh)	10
f) Çmimi i energjisë së ofruar për shitje (euro/MWh) në kontratën e shitblerjes	40
g) Koha e fillimit të prodhimit të energjisë elektrike	10

- Afati maksimal për kontratën e shitblerjes së energjisë do të jetë 10 vjet.
- Autoriteti kontraktues do të përcaktojë sasinë dhe fuqinë maksimale vjetore të energjisë për blerje në kontratën e shitblerjes.